

QBD, Mblidhet Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën



Në mjediset e Qendrës së Botimeve për Diasporën, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën. Ky komision është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizmin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë". Gjatë kësaj mbledhjeje u zgjodh Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, përkatësisht znj. Anila Ferizaj në pozicionin e kryetares dhe znj. Shqipe Gashi-Ramadani në pozicionin e zëvendëskryetares. Në këtë mbledhje u rishikua dhe u finalizua Rregullorja e organizimit të Punës së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, e cila ishte hartuar në mbledhjet e mëparshme të këtij Komisioni. Të pranishmit ranë dakord edhe për miratimin e "Kalendarit të Ri të Punës 2020-2021 të Komisionit të Përbashkët për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën". Kjo mbledhje u zhvillua duke respektuar të gjitha masat e marra për mbrojtjen ndaj Covid-19.

QBD, miratohet "Kalendarit i Ri i Punës 2020-2021 i Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën"



Në mjediset e Qendrës së Botimeve për Diasporën, vijoi mbledhja e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizmin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë". Gjatë kësaj mbledhjeje u përcaktua dhe u miratua "Kalendarit i Ri i Punës 2020-2021 i Komisionit të Përbashkët për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën". Kjo mbledhje u zhvillua, duke respektuar të gjitha masat e marra për mbrojtjen ndaj Covid-19.

Media shqiptare në Zvicër, "Pointegra.ch", promovon platformën "Rrjeti i Profesionistëve"



Media shqiptare në Zvicër, "Pointegra.ch", promovon platformën "Rrjeti i Profesionistëve" (<https://rrjetiprofesionisteve.al/>), produkt i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Portali i bën thirrje komunitetit të profesionistëve shqiptarë në Diasporë të bëhen pjesë e Rrjetit për të shkëmbyer informacion e ekspertizë e bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

D Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

KKD / Mark Gjonaj vjen me një tjetër nismë për mbrojtjen e jetëve të komunitetit

Z. Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut, vjen me një tjetër nismë për mbrojtjen e jetëve të komunitetit ku ai është zgjedhur përfaqësues. Përkrah anëtarit të Asamblesë së New York-ut, Micheal Benedetto, ai u bën thirrje autoriteteve lokale për rritjen e sigurisë në ujërat përreth City Island, pas ngjarjeve të fundit të shkaktuara nga mjetet lundruese.



KKD / shpreh ngushëllimet për Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama



I nderuar Zoti Kryeministër

Ju shprehim ju dhe familjes suaj ngushëllimet tona më të sinqerta për humbjen e nënës suaj Znj. Anela Rama. Qoftë i paharruar kujtimi i saj si dhe lehtësim i dhimbjes që ju ka tërë pas!

Marrim të gjithë pjesë në hidhërimin tuaj!

Me respekt
Anëtarët e Këshillit
Koordinues të Diasporës



May loving memories ease your loss and bring you comfort

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):